ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS***

Për Aktivitetin e Prokurimit: **124000-22-9932-2-2-1 nr.brend. 124 22 015 221**

Sa i përket tenderit për ***"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të ASK-së"***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH "BESI"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lidhja e Prizrenit Nr.23
(Adresa)
Prishtine ***10000***
(Vendi) *(Kodi postar)*
049/123981 ***n/a***
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Besim Kozmaqi_
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
servisbesi@hotmail.com
(Adresa elektronike)

25.01.2023
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- *Njoftimi per kontrate 28.09.2022*
- *Proces verbali i hapjes se Tenderve-2.pdf 19.10.2022*
- *Njoftimi per Vendimimin e AK 12.12.2022*
- *Afati i fundit i dorezimit te tenderit 19.10.2021 ora 14:00*
- *Kriteret e Dhenies se tenderit:* ***Çmimin më te ulët*** ☒ *apo Tenderi i përgjegjshëm* ***ekonomikisht më i favorshëm i*** *përcaktuar sipas kriterit të peshës të përshkruar në Aneksin 6* ☐

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] ***Jo*** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Me daten 15.12.2022 kemi bere kerkese per rishqyrtim pran AK, dhe me daten 23.12.2023 pranojme Vendimin nga AK ku te njejtit refuzojne kerkesen tone per Rishqyrtim qe eshte konstatim i paqendrueshem dhe i pa baze ligjore .

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 6.-Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7.-Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
- **Neni 59. I LPP-se- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**
- **Neni 59 i LPP-se pika 3 dhe Neni 41 i RRUOPP.-pika 41.8**
- **Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria NTSH "BESI" me seli në Prishtinë **(me tej: Ankuesi),** brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 per kerkese per Rishqyrtim, respektivisht, brenda afatit të lënë për ankese paraqet këtë:

ANKESE

per shkak te:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike
- Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale

Më të cilin Ankese **Ankuesi godet në tërësi Vendimin, *përshkruar me lartë,* si akt administrativ të paqëndrueshëm, të ngutshëm, subjekiv dhe absolutisht të pabazë dhe**

Propozon që

Ankesen e paraqitur nga Ankuesi ta **miratoj** si të bazuar në Ligj, Vendimin per tenderuesin e eliminuar ta **ABROGOJ,** respektivisht, **ANULOJ – Vendimin per anulimin e kesaj procedure te prokurimit ta Anuloj** dhe AK te vazhdon me tutje me proceduren e prokurimit per projektin e lartepermendur.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të ASK-së"*** " me nr. te prokurimit: **124000-22-9932-2-2-1 nr.brend. 124 22 015 221**, me dt: 23.12.2022 kemi pranuar pergjegjejen per Kekrkesen per rishqyrtim e cila vetem verteton Letren standarde per tenderuesin e eliminuar dhe njeherit si rezultat i ketij aktivitetit AK-Agjencia e Statistikave te Kosoves ka bere anulimin e aktivitetit bazuar ne Vendimin e komisionit te vleresimit te aprovuar nga e ZPP me arsyetim "*bazuar ne pervojen me kontraten e fundit ku nuk kane qene te knaqur me sherbimet qe ka ofruar OE dhe i njejti ka kercnuar Menaxherin e Kontrates*". **Këtu nuk kemi te bëjmë fare me shkelje te LPP-se**
Kompania "Besi" shpreh shqetsimet lidhur me kete menyre tendencioze te vleresimit te ketije aktiviteti te prokurimit nga komisioni, gjegjesishte persona-individ qe ne menyre tendencioze arrijne qe neve si kompani te na demtojne.

Ne si kompani NTSH Besi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK ,lidhur me rezultatet e aktivitetit te prokurimit për Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve te ASK si dhe letren standard per tenderuesin e eliminuar.
Nga njoftimi i AK jemi të befasuar e për më teper të shokuar nga arsyetimi i AK lidhur me kompaninë tonë që kemi qenë kontraktues disa vite rradhazi dhe për qudi asnjëhere nuk kemi pranuar ndonjë vërejtje eventuale për mos respektim të kontrates conform specifikave dhe kushteve kontraktuale e aq ma pak kërcenues të zyrtareve të ASK.
Ju rikojtojme se ne jemi kompani ma bagazh pune qe nga viti 1968, duke shprehur gjithmon profesionalizmin dhe etiken e punës. Jemi kontraktues me shum Institucione Shtetërore dhe asnjëhere nuk kemi pas akuza të pabaza si në rastin e e AK dhe në këtë mënyrë nuk mund të na njollosni asnjëhere.
Në cilën bazë ligjore jan thirur për paknaqësin që keni paraqitur në shkresë të cilat janë të pa baza dhe pa asnjë provë.
Si mundet Institucioni të bie ndesh me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi dhe mbi gjitha ta marrë parasysh emailin e zyrtarit i cili ka qenë menaxher kontrate dhe gjatë periudhes kontraktuale nuk ka shpreh asnjhere paknaqesi dhe nuk ka paraqite asgjë me shkrim për ndonjë vërejtje eventuale gjatë periudhës kontraktuale në implementim apo ndoshta keni qenë të obliguar ta gjejne një arsyeje banale, vetëm për tu bërë anulimi i tenderit për qëllime dhe apetite të ndryshme.(pse nuk kan ofruar asnje prove per shqetesimet e qe i kane ne lidhje me mosimplementimin e kontrates sipas kushteve dhe kritereve te parapara)
Ajo që AK nuk i ka takuar të konstaton se arsyet mbi bazën e të cilave si kompani e përgjegjëshme conform LPP nuk shperblehem me kontratë janë të papranueshme dhe nuk janë të vërteta, pasi AK mund të keni dyshime dhe mbi bazën e tyre si zyrtari juaj është dashtë të ju drejtohet Institucioneve kompetente, por jo të sillin përfundime të tilla pasi sipas detyrës zyrtare **zyrtari përgjegjës i prokurimit** , **nuk eshte Gjykatës**, e aq më pak i autorizuar sipas detyrës zyrtare për të vendosur për këtë rast se kush ka pasur të drejtë. Madje shkresa e AK përmban elemente të përpjekjesë së frikësimit e shantazhimit pasi as nuk e kamë dëshirën, por as edhe mundësinë që tua ndaloi që të ndiqin rrugët ligjore madje e kemi obligim me ligj të japim edhe këshillat se ku duhet ta adresojn ankesën e AK dhe nuk mundë të më friksojne me emailat e zyrtarve të AK që janë të pa baza , por ka qenë e rruges që zyrtari përgjegjes që ti ndjek rrugët qoftë edhe në aspektin penal, pasi AK të paktën këtë duhet ta dini se kallëzimi penal i rrejshëm përmban vepër penale. Por nëse i kan provat do duhej ti procedonin , e jo të praktikojn metoda të tilla për eliminimin dhe shantazhimin ndaj kompanisë sonë.
AK me veprimin e bërë duke pranuar një "email" nga zyrtari i vete i cili me shumë përgjegjësi e them që çdo fjali e tij është e pa vërtet ,si kan mundur të pranojn

emailin e pa argumentuar me prova dhe të favorizojn zyrtarin e papërgjegjëshem dhe në këtë mënyrë AK të merr veprime në kundershtim me ligjet dhe aktet nënligjore.
Aq thjeshtë ZPP është dasht të analizon emailin dhe duke kërkuar prova nëse zyrtari si menaxher i kontrates ka ndonjë email për paknaqesit ose vërejtjet që nëse ka adressuar tek kompania jonë gjatë periudhes implementimit kontrates sa ka qenë menaxher i kontrates.
Mbi cilin ligj ose akt nënligjor komisioni vlerësues rekomandon dhe si ZPP(zyrtar përgjegjës i prokurimit) pranon anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe konstaton se jemi të papërgjegjëshem.
Andaj kerkoj nga ana juaj që ti analizoni të gjitha faktet,dëshmit dhe të merni veprimet qe ju takojnë juve si Institucion ndërsa për zyrtarët e papergjegjeshem le ti adresojnë paknaqesit,shantazhet dhe kërcenimet në Institucione kompetente, e jo në këtë mënyrë të pa bazuar duke na dëmtuar ne si kompani me shantazhet ,kërcenimet nga një zyrtar i papërgjegjëshem.
Në mbështetje të nenit 108/A pika 2 e Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 kërkoi nga AK-Agjencia e Statistikave të Kosovës të analizoi dhe shqyrtoi kërkesën tonë duke na argumentuar me provat e prekshme lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve te ASK dhe të anuloi vendimin e AK dhe lënda të kthehet në rivlerësim të shpërblehemi me kontratë.
Bazuar ne te gjitha qe u ceken me larte kërkoi nga ana juaj qe Ankesen ton ta aprovoni si të bazuar duke marr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE NTSH "BESI" ." lidhur me tenderin : ***Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të ASK-së"***
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK Vendimin per tenderuesin e eliminuar ta **ABROGOJ,** respektivisht, **ANULOJ** .
ANULOHET vendimi per anulimin e kesaj procedure te prokurimit.
SHPERBLEN me kontrate OE NTSH " Besi" pasi tederi i jone te gjitha kriteret e kerkuar i plotesone ne tersi, administrativisht, teknikisht dhe me çmimin më te ulët ne poentim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e

kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*